

DEKRET
Nr.255, datë 17.7.1992

PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1874, DATË 7.6.1954 "MBI SHTETËSINË SHQIPTARE"

Në mbështetje të nenit, 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Në nenin 3 të dekretit "Mbi shtetësinë shqiptare" shtohen këto paragrafe:

"Të huajve me kombësi ose origjinë shqiptare, në bazë të kërkesës së tyre, u jepet shtetësia shqiptare, duke ruajtur ose jo edhe shtetësinë e shtetit të vet.

Personat që do të rezultojnë me shtetësi të dyfishtë si pasojë e zbatimit të këtij dekreti, do të gëzojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrat që parashikohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SALI BERISHA